



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:127898
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05507802

C.nr.514/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit M.I, nga fshati Celinë, komuna Rahovec, mësimdhënës në shkollën “Faik Konica” në fshatin Celinë, komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i tij i autorizuar avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor B.O, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë ditëve të punës – shujtës ditore, vlera e kontestit **648.00** Euro, jashtë seance, më 26.03.2024, morri këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit M.I:

DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë (shujtës ditore) paditësit ti paguaj si vijon: -

Paditësit **M.I**, në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë ditëve të punës për 324 ditë (nga data 21.01.2021 e deri me 21.11.2022, në vlerë prej dy (2)€ për një ditë pune, shumën prej **648.00€**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, nga data e parashtrimit të padisë, 06.06.2023 e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditës nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasoja ligjore të përmbarimit të detyrueshëm **SI ME BAZË**.

DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësve t’ua paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 125,00 Euro me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi M.I, me datë 06.06.2023 kësaj gjykate i kanë ushtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, për shkak të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojnë si mësimdhënës në SHFMU “Faik Konica” në fshatin Celinë, komuna Rahovec, që për periudhën e kërkuar paditësve i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës ,të datës 21.01.2021 por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022.

E paditura në përgjigjen e saj në padi të datës 14.12.2023, ka theksuar se ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se paditësit kanë ushtruar padi në gjykatë më 06.06.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, për periudhën kohore nga 21.01.2021 e deri më 21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Paditësit, referuar Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, me kërkesëpadi kanë kërkuar kompensim përtej vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, ngase KKAK e datës 18.04.2017 ka qenë në fuqi deri më 21.01.2021. E paditura konsideron se gjykata duhet të merr për bazë vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e KKAK-së të vitit 2017, afati i zbatimit i së cilës është përcaktuar sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023, Kapitulli II pika IV, nga hyrja në fuqi, në mënyrë që padia e paditësve të ketë themelësinë e saj sa i përket bazës ligjore. Nga kjo rezulton qartë se nuk mund të kërkohej kompensim për periudhën përtej vlefshmërisë së kontratës. ashtu që kërkesëpadi e paditësve qartazi është përfshirë në parashkrim, ngase kanë kaluar më shumë se tre vjet nga hyrja në fuqi e kontratës në të cilën paditësit janë thirrur, e tërë kjo konform nenit 87 të Ligjit të Punës i Kosovës. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka bërë administrimin e këtyre provave: për paditësin **M.I**, vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë Nr.13150/3 të datës 06.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Faik Konica” në fshatin Celinë komuna Rahovec dhe kontrata e punës për mësimdhënës me numër protokollit 395/3 e datës 01.09.2015.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe përgjigjes në padi nga ana e të paditurës, në bazë të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadi e paditësve është e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë administrimit të provave kjo gjykatë në bazë të vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë Nr.1315/3 të datës 06.04.2023, i lëshuar nga SHFMU “Faik Konica” në fshatin Celinë komuna Rahovec , ka vërtetuar faktin se paditësi M.I në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në vendin e punës 324 ditë të punës.

Gjatë administrimit të kontratës së punës kontratën e punës nr. Protokollit 395/3 e datës 01.09.2015 , gjykata vërtetuar faktin se paditësi M.I, ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, në institucionin arsimor SHFMU “ Faik Konica”, në fshatin Celinë, komuna e Rahovecit,

Sa i përket pretendimeve të palës së paditurës, gjykata vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe se të njëjtat nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, andaj edhe faktet përfundimtare nuk ishin kontestuese lidhur me vendimin meritor në këtë çështje kontestimore.

Sipas dispozitës së nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017, është paraparë se: ”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është dy (2) Euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënie të punës primare në institucionet arsimore”. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara

në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se, kërkesëpadia e paditësve duhet të aprovohet në tërësi. Si përfundim gjykata vlerësoi se kjo e drejtë i takon paditësve në kuptim të dispozitave të lartcekura, për çka dhe vendosi që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësve t'ua bëjë kompensimin për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Duke vërtetuar në këtë mënyrë gjendjes faktike me prova materiale bindëse, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 35.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, kjo gjykatë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382, të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së, dhe vendosi që e paditura t’ia kompensoj paditësve shumën prej 125.00€, e që kanë të bëjnë: për përpilimin e padisë shumën prej 104.00,€ dhe për taksën gjyqësore shumën prej 21,00 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.514/2023, më 26.03.2024

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimi. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë – divizionit civil.